

KËRKESË-ANKESË

Drejtuar: Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve (KAS), pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Tiranë

Kërkues: Astrit Kaziu, i biri i Fadilit dhe i Afërditës, lindur dhe banues në Peqin, lagjja "Xhami" me arsim të lartë

Objekti: Kundërshtim i Vendimit nr. 181 datë 08/10/2024 i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për plotësimin e vakancës të krijuar në Këshillin Bashkiak Peqin, nga mandati i ndërprerë i këshilltarit Zj. Anxhela Tabaku me Zj. Donika Ded Karina e cila në listën shumëemërore të kandidatëve për anëtar këshilli të subjektit zgjedhor Partia Socialiste mban numrin 13 (trembëdhjetë).

Baza Ligjore: Ligji Nr. 44 datë 30.04.2015, KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, neni 3, pika 7, germa "a", neni 33, pika 1, germa "a"

Ligji Nr. 10019, datë 29.12.2008, KODI ZGJEDHOR I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË i ndryshuar, neni 123 pika 1 dhe 2, neni 164, pika 2,

Të nderuar anëtarë,

Unë Astrit Kaziu, banues në Peqin, jam i regjistruar në listën shumëemërore për Këshillin Bashkiak të Bashkisë Peqin në numrin rendor 10 (dhjetë), propozuar nga subjekti zgjedhor Partia Socialiste. Në zgjedhjet vendore të 14 maj 2023 numri i këshilltarëve që fitoi Partia Socialiste ishte 9 (nëntë), nga të cilët 5 (pesë femra) dhe 4 (katër meshkuj). Në muajin korrik 2024 është krijuar vakanca në këshillin Bashkiak Peqin, nga këshilltari Zj. Anxhela Tabaku, i subjektit zgjedhor Partia Socialiste. Në parantezë ju ve në dijeni se nuk kam marrë asnjë njoftim zyrtar për këtë vakancë të krijuar. Madje dhe në faqen zyrtare të internetit të Bashkisë Peqin nuk ka një vendim të publikuar (detyrim ligjor publikimi i vendimeve) për krijimin e vakancës. Për vakancën e krijuar kam marrë dijeni nga këshilltarë të Këshillit dhe nga publikimi në faqen e internetit i njoftimit për mbledhjen e Këshillit të Bashkisë datë 22.07.2024, ku një ndër pikat e rendit të ditës ishte dhe „Mbi marrjen e mandatit të anëtarit të ri të Këshillit Bashkiak.

Menjëherë pas kësaj i kam kërkuar Sekretarit të Këshillit dokumentacionin e ardhur nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Ai më ka informuar dhe më ka dhënë një shkresë me nr.2456 datë 13.08.2024 te Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve në të cilën ndër të tjera thuhet se mandati i këshilltarit i kalon numrit 13 Zj. Donika Ded Karina.

(sepse sipas sekretarit më 11 me emrin Pranvera Karaj do ikte në Itali)

As. Kaziu

Duke mos qenë dakord me përmbajtjen e kësaj shkrese, për arsye se emri im është në listë me nr.10 (dhjetë), bëra një ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, i cili më njoftoi me shkresën nr. 2629/1 Prot. Datë 01.10.2024, vendimin nr. 21 datë 12.09.2024 në të cilin është vendosur: Mospranimi për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 12 datë 10.09.2024 të z. Astrit Fadil Kaziu, me arsyetimin e drejte se kërkesa është pa objekt. Por në arsyetim të Vendimit të KAS thuhet që ankuesi ka një interes të ligjshëm dhe në këto kushte i rekomandon administratës së KQZ-së të njoftojë Z. Astrit Fadil Kaziu për të qenë prezent në procedurën që do të zhvillohet nga KSHZ për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Peqin, në mënyrë që të ketë mundësi të parashtrijë dhe të dëgjohet mbi kërkesat dhe pretendimet e tij për këtë çështje.

Jam njoftuar në telefon nga Zj Pavlina që të paraqitem në KQZ Tiranë, datë 08.10.2024 ora 12:30. Jam paraqitur në KQZ Tiranë në orën e 12:00 të datës 08.10.2024 dhe nuk më futën brenda që të marr pjesë në mbledhje, dhe për pak minuta më njofton që procedura u mbyll dhe u mor vendim që vakanca plotësohet me nr rendor 13, me Zj. Donika Ded Karina. Biseduam vetëm 5 minuta tek dezhurni dhe jo në zyrë. I shqetësuar i them: si është e mundur të merrni një vendim, ku une pretendoj që kam një interes të ligjshëm dhe duhej të më dëgjonit. Nuk më dha asnjë arsyetim bindës.

Të nderuar anëtarë të KAS-it.

Në referim të Ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008, KODI ZGJEDHOR I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË i ndryshuar, neni 164, pika 2, thuhet : Mandati i ndërprerë i deputetit ose i anëtarit të këshillit të bashkisë i kalon kandidatit vijues të listës së të njëjtës parti politike në zonën zgjedhore përkatëse, përveçse kur plotësimi i vakancës me kandidatin e radhës ul përfaqësimin e gjinisë së nënpërfaqësuar. Në këtë rast plotësimi i vakancës bëhet nga kandidati i parë në listë i gjinisë së nënpërfaqësuar pavarësisht renditjes në listë. Emrat e tjerë të asaj gjinie ngjiten në listë duke marrë renditjen e kandidatit paraardhës të së njëjtës gjini. Ky rregull nuk zbatohet kur emrat e gjinisë përkatëse kanë shteruar.

Në interpretim të këtij neni kuptoj që femrat (anëtare këshilli) në Këshillin Bashkiak Peqin të subjektit zgjedhor Partia Socialiste nuk janë gjini e nënpërfaqësuar (anëtare këshilli të Partisë Socialiste ishin 5 femra dhe 4 meshkuj), madje Kryetar i Këshillit është femër.

Në Ligjin Nr. 10019, datë 29.12.2008, KODI ZGJEDHOR I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË i ndryshuar,

neni 2 Përkufizime, në pikën 26 thuhet:

26. "Gjini e nënpërfaqësuar" është gjinia me tradicionalisht numrin më të vogël të anëtarëve në Kuvend ose, sipas rastit, në këshillat vendorë në rang vendi.

Unë nuk di sa është numri i këshilltarëve femra dhe meshkuj në rang vendi, unë nuk di sa është numri i femrave dhe meshkujve anëtarë këshilli të subjektit zgjedhor Partia Socialiste në rang vendi.

Subjektet zgjedhore kanë detyrim ligjor sipas ligjit 10019, neni 67 pika 9; ku thuhet:

"Në zgjedhjet për këshillat bashkiakë një në çdo dy emra të njëpasnjëshëm në renditje të

kandidatëve të subjekteve zgjedhore duhet t'i përkasë së njëjtës gjini".

Unë gjykoj se vijimi i listës duhet të vazhdojë me nr. 10 që është emri im, vijim i cili nuk shkel Ligjin Nr.9970, datë 24.7.2008 PËR BARAZINË GJINORE NË SHOQËRI, neni 15, pika 1, ku thuhet:

1. Përfaqësimi i barabartë gjinor në të gjitha organet e pushtetit legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor dhe në institucionet e tjera publike arrihet kur:

c) sigurohet përfshirja mbi 30 për qind e secilës gjini në listën e kandidatëve për zgjedhjet në organet përfaqësuese vendore;

Përsa parashtrova më lart:

Kërkoj:

Shfuqizim i Vendimit nr. 181 datë 08/10/2024 i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, si të pabazuar në Ligj.

Me Respekt

Astrit Kaziu




Astrit Kaziu

0692173740

Bashkelidhur:

1. Shkresë nr.2456 datë 13.08.2024 e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
2. Shkresa nr. 2629/1 Prot. Datë 01.10.2024, vendimi nr. 21 datë 12.09.2024 i KAS.
3. Vendimi nr. 181 datë 08/10/2024 i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
4. Kopje letër njoftimit



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 08.10.2024

Nr: 181

Ora: 12:00

VENDIM

PËR

**PLOTËSIMIN E VAKANCËS NË KËSHILLIN E BASHKISË PEQIN, ME KANDIDATIN
NGA LISTA SHUMEMËRORE E "PARTISË SOCIALISTE TË SHQIPËRISË", ZJ.
DONIKA DED KARINA**

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronja "n" e 2 dhe 164, pikat 2 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", Kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit, "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", pasi shqyrtova dokumentacionin përkatës,

VËREJ:

Me shkresën nr. 1456 prot., datë 22.07.2024, këshilli i bashkisë Peqin, ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës nga këshilltari, zj. Anxhela Shkëlqim Tabaku, propozuar nga subjekti zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë.

Referuar nenit 164, pika 2 të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, kandidati vijues nga lista shumemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, për këshillin e bashkisë Peqin, të cilit i kalon mandati i këshilltarit, është kandidati me numër rendor 13, zj. Donika Ded Karina.

Me shkresën nr. 2456, prot., datë 13.08.2024, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i është drejtuar kandidatit për anëtar në Këshillin e Bashkisë Peqin zj. Donika Ded Karina, me kërkesë për plotësim dokumentacioni.

Në bazë të nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të dhënave në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat të listës shumemërore për zgjedhjet

Data: 08.10.2024 Nr: 181
Ora:12:00



"Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Peqin, me kandidatin nga lista shumemërore e "Partisë Socialiste të Shqipërisë" zj. Donika Ded Karina"

pararendëse, për këshillin bashkiak, të cilit i takon të marrë mandatin e këshilltarit për vendin vakant.

Kandidati për këshilltar, përcaktuar në bazë të listës shumëmemërore, të subjektit Partia Socialiste e Shqipërisë, ka plotësuar e depozituar formularin e vetëdeklarimit, me numër EL-PS-3419_1 unik, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik, ku përfshihet dhe funksioni i këshilltarit të bashkisë.

Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit të zj. Donika Ded Karina, rezulton se nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr. 138/2015.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në zbatim të ligjit nr. 138/2015 dhe Kreut V, pika 2, shkronja "b" dhe pika 3, shkronja "c", të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit me shkresën nr. 2585 prot., datë 04.09.2024, ka kërkuar informacion nga Zyra e Gjendjes Civile, dhe me shkresën nr. 2583 prot., datë 04.09.2024, ka kërkuar informacion nga Zyra e Gjendjes Gjyqësore, për zj. Donika Ded Karina.

Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Civile, me shkresën nr. 9786/1 prot., datë 13.09.2024, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e të dhënave për kandidatin për anëtar zj. Donika Ded Karina, ku konstatohet se kandidati nuk ka ndryshime në përbërësit e gjendjes civile.

Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore, me shkresën nr. 14085/1 prot., datë 13.09.2024, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për zj. Donika Ded Karina, ku konstatohet se kandidati nuk është i dënuar me vendim penal të formës së prerë.

Në mbështetje të pikës 2, të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit konstatohet se të dhënat e kandidatit për anëtar zj. Donika Ded Karina, në Këshillin e Bashkisë Peqin, nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e kandidatit në funksionin e këshilltarit.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja "n" e 2 dhe 164, pikat 2 dhe 4 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, nenin 11, të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", Kreun V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit, "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike"

Data: 08.10.2024 Nr: 181
Ora: 12:00



"Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Peqin, me kandidatin nga lista shumëmemërore e "Partisë Socialiste të Shqipërisë" zj. Donika Ded Karina"

VENDOS:

1. Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Peqin, me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, zj. Donika Ded Karina.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga hyrja e tij në fuqi.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Illirjan CELIBASHI

Data: 08.10.2024 Nr: 181
Ora: 12:00



“Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Peqin, me kandidatin nga lista shumemërore e “Partisë Socialiste të Shqipërisë ” zj. Donika Ded Karina”